



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KAVAJË

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Data: 08.10.2019

Për: Bashkimin e Operatoreve Ekonomik "Boshnjaku B" sh.p.k & "Bajrami N."sh.p.k

Procedura e prokurimit: "PROCEDURE E HAPUR"

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF- 23534 - 05 - 23 - 2019**

Objekti i kontratës : "**Rikonstruksion i linjave te Puseve 281, 282, 283, Depos 500 m3, Ndertimi i pusit 7, Cerme "**

Fondi limit : **60 773 649** (*gjashtedhete milion e shtateqind e shtatedhete e tre mije e gjateqind e dyzet e nente*) **leke pa T.V.SH**

Afati kohor për ekzekutimin: **6 (gjashte) muaj**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët • oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. "**AL-ASFALT**" sh.p.k Nipt. K81511508A

Vlera: 50 379 230 (*pesedhete milion e treqind e shtatedhete e nente mije e dyqind e tridhete*) leke pa TVSH .

2. "**ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCTION**" sh.p.k, Nipt K91326028I

Vlera: 57 719 371 (*pesedhete e shtate milion e shtateqind e nentembedhete mije e treqind e shtatedhete e nje*) leke pa TVSH.

3. "**B-93**" sh.p.k. Nipt J62903508R

Vlera: 54 058 598 (*pesedhete e kater milion e pesedhete e tete mije e peseqind e nentedhete e tete*) leke pa TVSH .

4. "BIBA-X " sh.p.k Nipt. K32618815N

Vlera: 51 657 602 (*pesedhjetë e një milion e gjashtëqind e pesedhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e dy*) leke pa TVSH

5. " BOSHNJAKU B. " sh.p.k. Nipt K72627402H

Vlera: 49 654 253 (*dyzet e nëntë milion e gjashtëqind e pesedhjetë e katër mijë e dyqind e pesedhjetë e tre*) leke pa TVSH

6. " MIKAEL GROUP " sh.p.k. Nipt K64108001G

Vlera: 0 (*zero*) leke pa TVSH

7. " PESE VELLEZERI" sh.p.k. Nipt L22925402C

Vlera: 56 164 180 (*pesedhjetë e gjashtë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind e tetë dhjetë*) leke pa TVSH

8. "SHENDELLI " sh.p.k. Nipt K07924803N

Vlera: 51 942 159 (*pesedhjetë e një milion e nëntëqind e dyzet e dy mijë e njëqind e pesedhjetë e nëntë*) leke pa TVSH

Operatoret Ekonomike te s'kualifikuar:

1. **Oferta e B.O.E.: "SHENDELLI" Shpk & "ED KONSTRUKSION" Shpk**, nuk plotëson kriteret si më poshtë vijon: D.T. i "SHENDELLI" Shpk, ing. Gëzim Mihaj, është i dy punësuar. Ai është i punësuar pranë "SHENDELLI" Shpk dhe pranë "Egema" Shpk, me NIPT L02004011E. D.T. e "SHENDELLI" Shpk, ing. Valbona Tabaku, është e dy punësuar. Ajo është e punësuar pranë "SHENDELLI" Shpk dhe pranë "Selasa" Shpk, me NIPT J71826005F, me objekt veprimtarie "... Mbikqyrje e kolaudim të të gjitha punimeve të zbatimit në fushën e ndërtimit e infrastruktures ndërtimore". D.T. i "SHENDELLI" Shpk, ing. Thanas Llahana, është i dy punësuar. Ai është i punësuar pranë "SHENDELLI" Shpk dhe pranë "PetraX" Shpk, me NIPT K12511610N. D.T. e "SHENDELLI" Shpk, ing. Engëllushe Sako, është e dy punësuar. Ajo është e punësuar pranë "SHENDELLI" Shpk dhe është e vetëpunësuar me NIPT L72606403D, me objekt veprimtarie "Vlerësimi i pasurive të paluajtshme, punime inxhinierike gjeodezi, ndërtim", me status AKTIV. D.T. i "SHENDELLI" Shpk, ing. Morin Xhikolli, është i dy punësuar. Ai është i punësuar pranë "SHENDELLI" Shpk dhe pranë "Muca" Shpk, me NIPT K01421002H, me objekt veprimtarie "Në fushën e ndërtimit, ndërtime civile dhe industriale, rikonstruksione etj. Aktivitet në fushën e ndërtimit.". D.T. i "ED KONSTRUKSION" Shpk, ing. Jeton Çela, është i dy punësuar. Ai është i punësuar pranë "ED KONSTRUKSION" Shpk dhe është i vetë punësuar me NIPT K42324002C, me objekt veprimtarie "Projektim, Supervizion, Kolaudim", me status AKTIV. D.T. i "ED KONSTRUKSION" Shpk, ing. Shpëtim HOXHA, është i tre punësuar. Ai është i punësuar pranë "ED KONSTRUKSION" Shpk, pranë "Assist" Shpk, me NIPT L52317008R, me objekt veprimtarie "...ndërtimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e pronave ...", me status AKTIV dhe pranë Agjencia e Prokurimit Publik. D.T. i "ED KONSTRUKSION" Shpk, ing. Vullnet Sejдини, është i dy punësuar. Ai është i punësuar pranë "ED KONSTRUKSION" Shpk dhe pranë "ALBANOPOL" Shpk,

me NIPT J64416216V, me objekt veprimtarie “Ndertime Civile e industriale rruge etj.”, me status AKTIV. D.T. e “ED KONSTRUKSION” Shpk, ing. Peva Çollaku, eshte e dy punesuar. Ajo eshte e punesuar prane “ED KONSTRUKSION” Shpk dhe prane Kisha Orth Auto e Shqiperise. D.T. i “ED KONSTRUKSION” Shpk, ing. Konalsi Gjoka, eshte i tre punesuar. Ai eshte i punesuar prane “ED KONSTRUKSION” Shpk, prane Qendra “Edmi”, me NIPT L81323454W dhe prane Fakulteti inxhenj. Ndertimit. D.T. i “ED KONSTRUKSION” Shpk, ing. Bledar Bregu, nuk eshte me i punesuar prane “ED KONSTRUKSION” Shpk nga muaji nentor 2018. Ai ka qene i punesuar prane “ED KONSTRUKSION” Shpk nga muaji mars 2018 deri muajin nentor 2018. Nga muaji nentor 2018 eshte i punesuar prane “SRP ALBANIAN ENGJINEERING” Shpk, me NIPT L81828013G. Per kete arsye licenca me nr NZ.4981/11, eshte e pavlefshme. D.T. i “ED KONSTRUKSION” Shpk, ing. Pandeli Berberi, eshte i dy punesuar. Ai eshte i punesuar prane “ED KONSTRUKSION” Shpk dhe prane “Alb – Star” shpk, me NIPT J62903512W, me objekt veprimtarie “Ndertime civile, industriale, tregti import export”. D.T. Ing Ervin Binaj, rezulton te jete rezident ne shtetin e Omanit dhe njekohesisht rezulton te jete njekohesisht i punesuar prane nje shoqerie (Tecnimont) ne kete shtet, ne shkelje te plote te VKM se sipercituar. Mjeku Dashnor Yzeiraj, figuron ne listpagese me pagen 24.000 leke, ne kundershtim me legjislacionin e pages minimale dhe me nenin 45/2/d te sipercituar te LPP. Operatori ekonomik “Shendelli” Shpk ka paraqitur dokumentacion per pllakashtruesit Durim Dalipaj, Tani Nuhaj dhe Ervin Hoxhaj, nderkohe punonjesi Tani Nuhaj rezulton ne listpagese (Maj 2019) me pagen 24.000 leke, ne kundershtim me legjislacionin e pages minimale. “Shendelli” Shpk, elektrikisti Vullnet Metaj, muratori Dritan Muka, muratori Sefret Çepele, elektrikisti Eldri Murataj, paguhen ne kundershtim me ligjin me nr 9920, date 19.05.2008, “Per procedurat tatimore”, I ndryshuar, pasi nje pjese e tyre paguhen nen pagen minimale, ndersa pjesa tjeter paguhet me pak dite si te punesuar per here te pare. Operatori ekonomik “Shendelli” Shpk ka paraqitur dokumentacion per bojaxhinjte Nazif Cakaj, Xhevahir Nuhaj dhe Shkelqim Rizaj, nderkohe, punonjesit ne fjale rezultonjne ne listpagese (Maj 2019) me pagat perkatese 6.500 leke, 9.600 leke dhe 6.000 leke. “Shendelli” Shpk, Engjellushe Koçi Balla, nuk figuron ne listepagese ndersa eshte deklaruar me kontrate dhe diplome. “Shendelli” Shpk, nuk ka plotesuar sakt shtojcen 1.1 DEKLARATË Për paraqitje Oferte të Pavarur. Ne Dokumentat e tenderit, eshte percaktuar se : 6. Ofertuesi deklaroi se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme): a). dhe b), ku ofertuesi duhet te percaktoj nje nga dy opsionet. Ky ofertues ka plotesuar opsionin e pare “Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër”, nderkohe qe ka mare pjese si bashkim operatoresh me “Ed Konstruksion” Shpk. “Shendelli” Shpk, nuk ka plotesuar shtojcen 11, Deklaratë Mbi Kontratat E Lidhura Dhe/ Ose Ne Proçes, ne menyre te plote me te gjitha te dhenat e sakta te puneve ne proces. Pas verifikimit te bere ne buletin nr 26, date 01.07.2019, rezulton se “Shendelli” Shpk, ne daten 19.06.2019, ka nenshkruar kontrate me Bashkia Tropoje, per realizimin e objekti: “Rikonstruksion rruga auto Lekbibaj – Curraj Eper”. Afati I punimeve 30 dite. Per kete arsye ky objekt duhet te deklarohet nga subjekti ne kete shtojce. “Shendelli” Shpk, nuk ka paraqitur dokumentacion qe ka shlyer detyrimet vendore ne Bashkia Tirane. Ne shtojcen 11, Deklaratë Mbi Kontratat E Lidhura Dhe/ Ose Ne Proçes, ka deklaruar se ka ne proces objektin: “Rikonstruksione Objekte Rekreative, Sanitare, Info Point, Objekte Shërbimi në Parqe (Ndërtim Montim)”, me autoritet kontraktor: Agjencia E Parqeve Dhe Rekreacionit, njoftimi i fituesit eshte shpallur ne daten 18.06.2019, ne buletin nr 8, date 25.02.2019, rezulton se “Shendelli” Shpk, ne daten 18.02.2019, ka nenshkruar kontrate me Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a., per realizimin e objekti: “Instalimi i sistemit ujematës ne burimet e ujesjellesit te Tiranes”. Ofertuesi, rezulton se nuk ka paraqitur dokument te leshuar nga Bashkia Tirane, ku te vertetohet se subjekti te kete shlyer detyrimet prane kesaj bashkie per vitin 2019.

“Shendelli” Shpk, nuk ka paraqitur dokumentacion qe ka shlyer detyrimet vendore ne Bashkia Roskovec. Ne dokumentat e tenderit, eshte paraqitur vertetim nr 2537/1 Prot., date 20.06.2018, leshuar nga Bashkia Roskovec, ku vertetohet se deri ne ate date nuk ka detyrime te pashlyera ndaj ketij institucioni. Me shkrese nr 4013 Prot., date 12.10.2018, me lende “NJOFTIM”, Bashkia Roskovec, njofton “Shendelli” Shpk, se ka nje detyrim te papaguar. Ofertuesi, rezulton se nuk ka paraqitur dokument te leshuar nga Bashkia Roskovec mbas njoftimit nr 4013 Prot., date 12.10.2018, ku te vertetohet se subjekti te kete shlyer detyrimet prane kesaj bashkie. Ne buletin nr 10, date 11.03.2019, rezulton se “Shendelli” Shpk, ne daten 05.03.2019, ka nenshkruar kontrate me Bashkin Roskovec, per realizimin e objekti: “Rikonstruksion i rruges se Kukallareve, Fshati Kurjan”. ne buletin nr 15, date 15.04.2019, rezulton se “Shendelli” Shpk, ne daten 05.04.2019, ka nenshkruar kontrate me Bashkin Roskovec, per realizimin me objekti: “Rikonstruksion i rruges Unaza - Lagjia e Dushkut”. Ofertuesi, rezulton se nuk ka paraqitur dokument te leshuar nga Bashkia Roskovec, ku te vertetohet se subjekti te kete shlyer detyrimet prane kesaj bashkie per vitin 2019. Ne dokumentat e tenderit, nga ofertuesi eshte paraqitur edhe dokumenti “Fature Arketimi”, me numer 65, date 02.05.2019, ku vertetohet se “Shendelli” Shpk ka nje detyrim kundrejte bashkise Kruje. Ofertuesi, rezulton se nuk ka paraqitur dokument te leshuar nga Bashkia Kruje mbas kesaj fature, ku te vertetohet se subjekti te kete shlyer detyrimet prane kesaj bashkie. Ne dokumentat e tenderit, nga ofertuesi eshte paraqitur edhe dokumenti “Urdher Pagese”, date 06.03.2019, ku vertetohet se “Shendelli” Shpk ka nje detyrim kundrejte bashkise Pogradec. Ofertuesi, nuk rezulton te kete paraqitur nje dokument te leshuar nga Bashkia Pogradec mbas ketij urdher, ku te vertetohet se subjekti te kete shlyer detyrimet prane kesaj bashkie. ne buletin nr 40, date 08.10.2018, rezulton se “Shendelli” Shpk, ne daten 28.09.2018, ka nenshkruar kontrate me Bashkin Pogradec, per realizimin e objekti: “Sistemim Blloku tek ish Ferma, Loti I”. ne buletin nr 40, date 08.10.2018, rezulton se “Shendelli” Shpk, ne daten 27.09.2018, ka nenshkruar kontrate me Bashkin Pogradec, per realizimin e objekti: “Rehabilitim/Përforcim banesash ekzistuese kolektive”. Ofertuesi, rezulton se nuk ka paraqitur dokument te leshuar nga Bashkia Pogradec, ku te vertetohet se subjekti te kete shlyer detyrimet prane kesaj bashkie per vitin 2018. Ne dokumentat e tenderit, nga ofertuesi eshte paraqitur edhe dokumenti “Fature per arketim”, me numer 2025, date 25.03.2019, ku vertetohet se “Shendelli” Shpk ka nje detyrim kundrejte bashkise Librazhd. Ofertuesi nuk rezulton te kete paraqitur nje dokument te leshuar nga Bashkia Librazhd mbas kesaj fature, ku te vertetohet se subjekti te kete shlyer detyrimet prane kesaj bashkie. Ne dokumentat e tenderit, nga ofertuesi eshte paraqitur edhe dokumenti “Akt detyrimi/fature per arketim”, date 25.03.2019, ku vertetohet se “Shendelli” Shpk ka nje detyrim kundrejte bashkise Divjake. ofertuesi, rezulton se nuk ka paraqitur dokument te leshuar nga Bashkia Divjake mbas kesaj fature, ku te vertetohet se subjekti te kete shlyer detyrimet prane kesaj bashkie. ne buletin nr 8, date 26.02.2018, rezulton se “Shendelli” Shpk, ne daten 20.02.2018, ka nenshkruar kontrate me Bashkin Durres, per realizimin e objekti: “Rikonstruksion fasada qytet”. Ne dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi, rezulton se nuk ka paraqitur dokument te leshuar nga Bashkia Durres, ku te vertetohet se subjekti te kete shlyer detyrimet prane kesaj bashkie per vitin 2018. “Shendelli” Shpk, nuk ka plotesuar kriterin per ing. Mjedisi. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë inxhinierët e mëposhtëm: Inxhinier Mjedisi 1 (një). Inxhinieret e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë për 6 muajt e fundit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Shendelli Shpk”, në mënyrë elektronike, nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike, vëret se, në përmbushje të kriterit të sipërcituar, operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion për dy punonjës inxhinier mjedisi konkretisht për znj. Saimira Topalli e cila nuk figuron si drejtues teknik në liçensën e operatorit

ekonomik ofertues dhe znj Silvana Jonuzi e cila nuk figuron në listëpagesën e shoqërisë për periudhën 6 muajt e fundit vërtetuar nga kontrata e punës e cila është lidhur në date 20.05.2019 midis palëve por dhe nga verifikimi i deklaratave të dorëzuara nga operatori ekonomik sipas "Listëpagesave të Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi" për 6 muajt e fundit. Konkretisht, rezulton se operatori ekonomik "Shendelli Shpk", nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për inxhinierin e mjedisit, duke mospërmbushur kriterin e vendosur, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit. Per drejtuesen teknike Znj. Silvana Jonuzi, inxhinieri mjedisi, qe gjenden ne licencen e shoqerise, shoqeria "Shendelli" Shpk nuk ka respektuar pikën 2/d të nenit 45 të LigjitNr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. "Shendelli" Shpk, nuk ka plotësuar kriterin per mjet autovinc APV. Nga dokumentacioni I paraqitur rezulton se ky subjekt ka paraqitur dokumentacion per mjetin AA409DR, I cili eshte nga leja e qarkullimit rezulton se eshte kamion me vinc dhe nuk eshte autovinc APV. Ky fakt mund te kompromentoj realizimin e punimeve pasi kamioni me vinc nuk ka kapacitet per te ngritur pasha sipas kerkesave te objektit. Gjithashtu ka paraqitur dokumentacion per mjetin me targe AA545JN dhe mjetin me targe AA696TY. Per te dy keto mjete mungon fotografia, ne kundershtim me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit. Nga dokumentacioni I paraqitur rezulton se ky subjekt ka paraqitur dokumentacion per mjetin SR4937B, I cili eshte nga leja e qarkullimit rezulton se eshte kamion me vinc dhe nuk eshte autovinc APV, kolaudimi I ka skaduar ne daten 29.06.2019. Autoboti uji me targ SR2857B,ka skaduar kolaudimi. Lidhur memjetin Asfalto-shtruese MT, operatori ekonomik "Shendelli" Shpk ka paraqitur kontraten e qirase Nr. 1019 Rep., Nr. 508 Kol., date 28.04.2011, me "Jody Kompany" Shpk, por alfaltoshtruesja e marre me qira "Simesa", Tip 2549. Nr. Shasie 00027, nuk rezulton te jete pajisur me leje qarkullimi, nderkohe ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar Asfalto-shtruese MT pajisur me leje qarkullimi. "Shendelli" Shpk, nuk ka plotësuar kriterin per makineri skarifikimi (freze per gerryerje asfalti), pajisur me leje qarkullimi. Te kater rrulat qe disponon operatori ekonomik "Shendelli" Shpk (dy te marre me qira, sipas kontrates Nr. 1019 Rep., Nr. 508 Kol., date 28.04.2011, nga "Jody Kompany" Shpk, nje I blere nga subjekti "Aruci Group" Shpk dhe nje I blere nga subjekti "Kriger" Shpk), nuk jane te pajisur me leje qarkullimi, kolaudim,

siguracion.

Sa më sipër, oferta e paraqitur nga B.O.E.: "SHENDELLI" Shpk & "ED KONSTRUKSION" Shpk, refuzohet për mospërmbushje të kriterëve të kualifikimit.

2. Oferta e B.O.E.: "B-93" Shpk & "LALA" Shpk & "ARKONSTUDIO" Shpk nuk plotëson kriteret si më poshtë vijon: Ing. Enver Vani drejtues teknik ne licencen e "B-93" Shpk, eshte i dypunesuar. Ushtron aktivitet privat me NIPT K92104010H, me fushe veprimtarie "Punime topografike", me status AKTIV. D.T. i "B-93" Shpk, ing. Fatmir Brati, eshte i dy punesuar. Ai eshte i punesuar prane "B-93" Shpk dhe prane shoqerise "Ufo" Shpk, nipt J82025002B. D.T. i "B-93" Shpk, ing. Vladimir MARKU, eshte I dy punesuar. Ai eshte i punesuar prane "B-93" Shpk dhe prane "ALBPETROL" Sh.A., nipt J82916500U. D.T. i "B-93" Shpk, ing. Florjan HOXHAI, eshte I dy punesuar. Ai eshte i punesuar prane "B-93" Shpk dhe prane Agjencia e Menaxhimit te Burimeve Ujore, nipt L42028454U. D.T. i "ArkonStudio" Shpk Gjon Leka, eshte i vetepunesuar me NIPT K417170100, në kundershtim me parashikimet në Kreun IV, pika 2, te VKM NR. 42, date 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar ku parashikohet se: "Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit: Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të

jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit”. D.T. i “ArkonStudio” Shpk, ing. Ermal Palushi rezulton rezident ne USA. D.T. i “ArkonStudio” Shpk, ing. Krenar Dila, është i dy punësuar. Ai është i punësuar pranë “ArkonStudio” Shpk dhe pranë “KEG” Shpk, nipt L91324017H. D.T. i “ArkonStudio” Shpk, ing. Dhimitraq Stefa, është i dy punësuar. Ai është i punësuar pranë “ArkonStudio” Shpk dhe është i vetë punësuar me nr NIPT K91305010Q, me objekt Projektim, mbykqyrje, kolaudim e zbatim ndertimesh, me status AKTIV. D.T. “ArkonStudio” Shpk, ing. Lediana Dila, është e dy punësuar. Ajo është i punësuar pranë “ArkonStudio” Shpk dhe pranë “ArchiMED S.P.S.” Shpk, nipt L12227027U, me objekt veprimtari “Projektim, ndertim, supervision...”. D.T. “ArkonStudio” Shpk, ing. Gjon Leka, është i dy punësuar. Ai është i punësuar pranë “ArkonStudio” Shpk dhe është i vetë punësuar me nr NIPT K41717010O, me objekt “Studime gjeologo-inxhinierike, gjeoteknike, hidrogeologjike, ambientale, vleresim i ndikimit ne mjedis, ekspertiza, konsulence, shpime autosonde per uje, pilotime, etj.”, me status AKTIV. D.T. “ArkonStudio” Shpk, ing. Dodë Marku, është i tre punësuar. Ai është i punësuar pranë “ArkonStudio” Shpk, pranë “STERKAJ” Shpk, nipt J68310708M, me objekt veprimtari “Ndertime civile e industriale te te gjitha llojeve,...” dhe pranë “CO-BETON” Shpk, nipt K71714501K. D.T. “Arkon Studio” Shpk, ing. Nasjel Çiço është i dypunësuar. Ai është i punësuar pranë “ArkonStudio” Shpk dhe pranë “MODESTE” Shpk, nipt J62903413B, me objekt veprimtari “Veprimtari ne fushen e ndertimit, ...”. D.T. “ArkonStudio” Shpk, ing. Albiona BERHANAJ, është e dy punësuar. Ajo është i punësuar pranë “ArkonStudio” Shpk dhe pranë “SEED CONSULTING” Shpk, nipt L41824014Q, me objekt veprimtari “... mbikqyrja (supervizionimi) i tyre, si kolaudimi i veprave ...”. “B-93” Shpk, vlere e zerave te punimeve te ngjashme te realizuara nuk plotesojne vleren e percaktuar ne dokumentat e tenderit per kete procedure prokurimi. “Arkonstudio” Shpk, ka paraqitur deklarate te rreme ne lidhje ne lidhje me taksat vendore. Ne daten 21.12.2018, ka nenshkuar kontraten per realizimin e objektit “Rikonceptim dhe rikonstrukcion i shkollës së muzikës Jani Kukuzeli, Durrës” dhe Ne daten 14.01.2019, ka nenshkuar kontraten per realizimin e objektit “Rikonstrukcioni i shkollës 9-vjeçare Armath, Manëz”, me Bashkia Durres. “Arkonstudio” Shpk, nuk ka paraqitur vertetim nga Bashkia Durres ku te vertetohet se ka shlyer detyrimet vendore per vitin 2018 dhe vitin 2019. “Arkonstudio” Shpk, ne shtojcen nr 11, ka deklaruar se po realizon objektin “Ndertim magazinash dhe rik. zyra ve ne Fier”, me autoritet Albgaz Sh.a. Nuk ka paraqitur vertetim nga Bashkia Fier ku te vertetohet se ka shlyer detyrimet vendore per vitin 2019. Ne daten 13.09.2018, ka nenshkuar kontraten per realizimin e objektit “Rik. shkollës “Astrit Hyka” dhe ndërtim I ambienteve sportive, fshati Kutalli”, me Bashkia Ura Vajguore. Nuk ka paraqitur vertetim nga Bashkia Ura Vajguore ku te vertetohet se ka shlyer detyrimet vendore per vitin 2018. Ne daten 04.07.2019, ka nenshkuar kontraten per realizimin e objektit “Ndërtim i shkollës 9 vjeçare 18 Tetori”, me Bashkia Kuçovë. Nuk ka paraqitur vertetim nga Bashkia Kuçovë ku te vertetohet se ka shlyer detyrimet vendore per vitin 2019. Ne daten 23.08.2018, ka nenshkuar kontraten per realizimin e objektit “Shtresë tapeti i rrugëve të lagjes “Bylis”, të bulevardit qëndror deri te shkolla “Odisea”, si dhe ndërtim trotuare e bordura në rrugët e lagjes “Bylis”, me BASHKIA Mallakaster. Nuk ka paraqitur vertetim nga Bashkia Mallakaster ku te vertetohet se ka shlyer detyrimet vendore per vitin 2018. Ne daten 07.09.2018, ka nenshkuar kontraten per realizimin e objektit “Rik Shkollës “Asim Zeneli” + Sistemimi i Jashtëm (Loti I + Loti II)”, me Bashkia Gjirokaster. Nuk ka paraqitur vertetim nga Bashkia Gjirokaster ku te vertetohet se ka shlyer detyrimet vendore per vitin 2018. B93 ne vitin 2018 ka ushtruar aktivitet edhe ne Tirane, per objektin ”Mirëmbajtje ndërtese dhe ambjenti rrethues të Universitetit të Tiranës”, Nr. REF 80355-07-23-2018, me AK Universiteti i Tiranës. Rrjedhimisht duhet te kishte paraqitur vertetim edhe per shlyerjet e taksave vendore ne Tirane per vitin 2018. Deklarata e paraqitur ku deklarohet se: “Unë i nënshkruari

Dashnor LICAJ me cilësinë Perf.Prok. të operatorit ekonomik “B ‘93” shpk, deklaroj se: Ne si operator ekonomik kemi paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2018, 2019 në vendet ku ne si operator kemi ushtruar dhe ushtrojme aktivitetet: është në kundërshtim me nenin 13, pikë 3, germa ”a” të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për Prokurimin Publik” dhe përben deklarament të rreme. Sipas ekstraktit të QKB “Lala” Shpk ushtron aktivitetet edhe në Paskuqan, Bashkia Kamez në vitin 2019 por nuk ka paraqitur vertetim për taksat vendore në këto adrese. Deklarata e paraqitur për shlyerjen e të gjitha taksave vendore është në kundërshtim me nenin 13, pikë 3, germa ”a” të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për Prokurimin Publik” dhe përben deklarament të rreme. Z. Banush Hoxhaj, paraqitur nga “B93” Shpk si teknik ndërtimi, sipas diplomes së paraqitur është specialist ndërtimi dhe jo teknik. Z. Zaim Dosti deklarohet si teknik ndërtimi, por s’ka dokument që e provon këtë. Për asnjë nga punonjësit e “Lala” Shpk nuk është paraqitur dokumentacion për të provuar se janë teknike ndërtimi (janë deklaruar dy të tilla). Saldatori i paraqitur nga “B93” Shpk Z. Qemal Kercani nuk figuron në asnjë muaj në listpagesat e shoqërisë. Në IQT, nr i serise në faqen e parë është i ndryshëm nga numri i serise në faqen e dytë të IQT-së. Arben Licaj Hidraulik, Muratori Ermir Liçaj dhe Eraldo Licaj murator, figurojnë në listpagesa vetëm në një muaj nga 6 të kërkuar, dhe me një ditë punë në këto muaj. Muratori Ermir Liçaj, mungon dëshmia e aftësisë profesionale. Manovratori Luftar Dosti, mungon dëshmia e aftësisë profesionale. Karpentieri Azem Skana edhe pse ka kontratë që në 2018 nuk figuron në listpagesat e B93” Shpk. Të gjithë punonjësit e sipërcituar janë të nevojshëm për këtë shoqëri për të kryer punimet që ka marrë për sipas marrëveshjes së bashkëpunimit dhe në respektim të nenit 74/3 të VKM Nr. 914 ,datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. “Lala” Shpk nuk ka deklaruar të gjithë vlerën e kontributeve të mjekut Gani Sakajani, paga e të cilit në kontratën e punës është 40.000 leke ndërsa në listpagesë: 13.000 leke. “B93” Shpk ka paraqitur dokumentacion për tre kamione, AA189IU, ku dy kamionet, me targë AA364PB dhe targë AA460DN janë mjete të marrë me qira, por në certifikatën e pronësisë të këtyre mjeteve, shënohet se janë “për përdorim vetjak” dhe duke qenë në këto kushte, këto mjete nuk mund të jepën me qira nga disponuesit e tyre. Sipas parashikimeve të nenit 184 të K. Rr. të Republikës së Shqipërisë. Të dy kamionet, me targë AA364PB dhe targë AA460DN janë mjete të marrë me qira, por në certifikatën e pronësisë të këtyre mjeteve, shënohet se janë “për përdorim vetjak” dhe duke qenë në këto kushte, këto mjete nuk mund të jepën me qira nga disponuesit e tyre. Grejder, “B93” Shpk ka paraqitur deklaratë doganore për një grejder me rrota (fotoja bashkelidhur është grejder me rrota) por nuk ka paraqitur Leje qarkullimi, siguracion. Edhe grejderi i “Lala” Shpk është pa këto dokumentacion. “Arkonstudio” Shpk nuk ka mjet të tilla. Asfaltoshtuese me goma Mt pajisur me leje qarkullimi “B93” Shpk ka paraqitur deklaratë doganore për dy mjete, por nuk ka paraqitur leje qarkullimi, siguracion, kolaudim. Edhe asfaltoshtuesja e “Lala” Shpk është pa këto dokumentacion. “Arkonstudio” Shpk nuk ka mjet të tilla. Autobot uji, “B93” Shpk ka paraqitur dokumentacion për mjetin me targë AA913DE, i cili sipas dokumentave është kamion me depozitë sipër. Në këto kushte, duhet të ishte pasqyruar ky ndryshim në lejen e qarkullimit, sipas parashikimeve në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, ky mjet nuk ka siguracion. Autopompe betoni, “B93” Shpk ka paraqitur dokumentacion për mjetin me targë Tr5537N, i cili nuk ka siguracion. Autopompat e “Lala” Shpk nuk ka leje qarkullimi, siguracion, kolaudim, taksa. “Arkonstudio” Shpk nuk ka mjet të tilla. Vinc kulle “B93” Shpk ka paraqitur dokumentacion për mjetin me targë TR7409S, i cili sipas dokumentave është kamion me koshe dhe jo vinc kulle. “Arkonstudio” Shpk dhe “Lala” Shpk nuk ka mjet të tilla. Rrul me kompresor gome - hekur MT i pajisur me leje qarkullimi, Rrul me vibrim hekur - hekur MT i pajisur me leje qarkullimi, Të gjithë mjetet rrul që disponon “B93” Shpk dhe “Lala” Shpk nuk kanë paraqitur leje qarkullimi, siguracion, kolaudim, të domosdoshme për mjetet vetëlevizëse, pasi kanë vetëm deklaratë

doganore. “Arkonstudio” Shpk nuk ka mjet te tille. “B93” Shpk, eskavatori me goma JCB, deklaruar me akt zhdoganimi eshte pa leje qarkullimi, siguracion dhe kolaudim. “B93” Shpk, nuk ploteson kriterin per asfalto beton. Mungon akti i pronesise se fabrikes se asfaltobetonit i “BI-Investiments”, Sh.A., qe “B-93” ka lidhur kontrate furnizimi me asfaltobeton. “B93” Shpk, minifadroma Bobcat, e blere nga Z. Agim Saliaj, mungojne fotot te mjetit. “Lala” Shpk, lidhur me mjetin eskavator me goma, LIBEHER, mungon leja e qarkullimit, koladuimi, siguracioni. “Lala” Shpk, lidhur me mjetin eskavator me zinxhir, nuk ka paraqitur foto. “Lala” Shpk, kamioni me targe HS0426A, nuk eshte me kapacitet mbajtes mbi 15 ton. “Lala” Shpk, mjeti ABR244, nuk eshte kamion por rimorkiator. “Lala” Shpk, kamioni TR5746P, nuk eshte me kapacitet mbajtes mbi 15 ton. “Lala” Shpk, mjeti HS1345A, nuk eshte kamioncine deri 6 ton, por kamion mbi 6 ton, vertetua nga leja e qarkullimit. “Lala” Shpk, kontrata e qirase me “Kastrati” Sh.A.;, per mjetet e paraqitura si autobot uji, nuk jane te vlefshme sepse keto mjete nuk jane autobot uji por atobot per transportuar lende te rrezikshme (nafte, enzie). Kjo e verifikuar ne sistemin e transportit rrugor si dhe ne dokumentacioni e paraqitur leje qarkullimit, kodi C3. “Lala” Shpk, kontrata e qirase me “Vllaznimi” Shpk, per kamion, kamioncine, fadrome, minisekavator, eskavator, autobetoniere, autopompe betoni, asfaltoshtruese, jane te angazhuara nga “Vllaznimi” Shpk per kontratat e lidhura me Bashkine Tropoje. “Lala” Shpk, mjeti i paraqitur si minifadorem (Bobcat), me fature blerje nr 19, date 16.02.2016, eshte pirun per ngritje dhe jo minifadrome. “Lala” Shpk, mungon deshmia e sigurimit teknik ose ekuivalent per teknikun e ndertimit Z. Agim Lala. Deshmia e paraqitur eshte per elektroteknik dhe jo teknik ndertimi si kerkohet ne dokumentat e tenderit. “Arkonstudio” Shpk do te kryeje punime saldimi, por nuk ka aparat saldimi. Gjithashtu, do kryeje punime hekuri por ska tranxh. “B-93” Shpk dhe “LALA” Shpk, nuk kane piken e licences NS16-B, te kerkuar ne DST, por kane piken NS 16-A, nderkoh qe ne ndarjen e punimeve kane marre zerat e punimeve qe lidhen me kete kategori licences. Ing. e mjedisit e deklaruar nga “Arkonstudio” Shpk rezulton me raport mjekesor. Mjekja e “Arkonstudio” Shpk eshte deklaruar te pakten nga muaji janar 2019 deri ne maj 2019, me vetem 3 dite per c’do muaj. Ing. Gjeodet Vladimir CV dhe diploma jane fotokopje, IQT e pavulosur te afati i vlefshmerise. “Arkonstudio” Shpk, manovratori Ibrahim Murataj, eshte pa deshmi e aftesise profesionale perkatese. “Arkonstudio” Shpk, punonjesit e kualifikuar se teknik ndertimi, hidraulik, karpentjer, saldator, manovrator, jane te siguruar te gjithë me nga 3 dite ne muaj per 6 muajt e fundit. Kjo ne kundersiztim me kontrata e punes se lidhur nderjmet paleve si dhe I gjin mbi sig. Shoq. Dhe shendetsore. Sa më sipër, oferta e B.O.E.: “B93” Shpk & “Lala” Shpk& “Arkonstudio” refuzohet për mospërmbushje të kriterëve të kualifikimit.

3. Operatori ekonomik Mikael Grup Shpk nuk ka paraqitur dokumentacion.

4. Oferta e B.O.E.: “Biba-X” Shpk & “Pe-Vla-Ku” Shpk nuk plotëson kriteret si më poshtë vijon:
D.T. i “BIBA-X” Shpk, ing. Alida HOXHA, eshte e dy punesuar. Ajo eshte e punesuar prane shoqerise “BIBA-X” Shpk dhe prane shoqerise “ELECTRICAL POWER ENGINEERING” Shpk, nipt K81511012V, me objekt “Punime germimi ne toke. Ndertim dhe rikonstruksion I ndertesave civile dhe industriale, antena dhe rrjete te telekomunikacionit...”. D.T. i “BIBA-X” Shpk, ing. Hyqmet MUKA, eshte e tre punesuar. Ai eshte i punesuar prane shoqerise “BIBA-X” Shpk, prane shoqerise “KAZIU. B” Shpk, nipt K83310801B, dhe gjithashtu eshte i punesuar prane Bashkia Kavaje. Ky fakt perben dy shkelje, e para sepse drejtuesi teknik nuk mund te jete i punesuar ne asnje subjekt tjeter pervec ku eshte drejtue teknik dhe e dyta ofertuesi shoqeria “BIBA-X” Shpk eshte ne konflikt interesi. D.T. e “BIBA-X” Shpk, ing. Arbana KOLA, eshte e tre punesuar. Ajo eshte e punesuar prane shoqerise “BIBA-X” Shpk, prane shoqerise “KARL GEGA KONSTRUKSION” Shpk, nipt J66703076W, me objekt veprimtarie “Ndertime civile, industriale, etj., Studimin, projektimin, konsulencen, siper marrjen zbatuese dhe/ose

